



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 20 Mars 2021

Nr: 08

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 05, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 19.03.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim PD-AN

**OBJEKTI:** Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.05, paraqitur në KQZ në datën 19.03.2021.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126, 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 pika 3, shkronja “a”, 18 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



## V Ë R E N:

Ankuesi Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN), ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr.05 regj, datë 19.03.2021.

Në mbledhjen e datës 20.03.2021, ora 18:30 pas relatimit të z. Elvin Lako, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 05 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të pranohet.

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.05, datë 19.03.2021, të paraqitur nga koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN).
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 23.03.2021, në orën 10:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Elvin LAKO - Relator**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**

